

---

# PLANPROGRAMI I SPECIALIZIMIT NGA PARODONTOLOGJIA DHE MJEKËSIA ORALE

---

## 1. PASQYRA E PËRGJITHSHME E SPECIALIZIMIT

### 1.1 Qëllimi i specializimit

Parodontologjia dhe mjekësia orale janë specializim stomatologjik. Specializimi është proces arsimor edukativ, nga i cili specializanti fiton njohuri teorike dhe praktike nga parodontologjia, mjekësia orale dhe implantologjia dentale, dhe aftësohet që të jetë i pavarur të trajtojë shumicën e të sëmurëve me sëmundje akute dhe kronike të indeve orale. Me trajtim nënkuptohet diagnostika, terapia, rehabilitimi dhe preventiva e sëmundjeve të parodontiumit dhe sëmundjeve të indeve orale.

### 1.2 Kohëzgjatja dhe struktura e specializimit

Kohëzgjatja e tërësishme e specializimit nga parodontologjia dhe mjekësia orale është 3 vjet ( 36 muaj) nga lëmitë si vijon:

- Parodontologjia, mjekësia orale dhe implantologjia stomatologjike 24 muaj
- Sëmundjet e dhëmbit dhe endodencia 3 muaj
- Kirurgjia orale dhe maksillofaciale 1 muaj
- Protetika stomatologjike 1 muaj
- Ortopedia e dhëmbëve dhe nofullave 1 muaj
- Radiologjia speciale 1 muaj
- Mjekësia interne- diabetologjia 1 muaj
- Dermatologjia 1 muaj
- Pushim vjetor 3 muaj

### 1.2 Përfundimi i specializimit

Mentori kryesor konstaton që specializimi ka përfunduar, verifikon rregullshmërinë e kohëzgjatjes së specializimit, plotësimin e kushteve të parapara për dijen e fituar, kualitetin e punëve të kryera dhe suksesin dhe numrin e duhur të kolokviumeve të kryera. Specializimi përfundon me provim specialistik praktik dhe teorik.

## 2. VERIFIKIMI I DITURISË

Çdo specializant ka librezën e vet të specializimit e cila shërben edhe si ditar në të cilën shënohen të gjitha punët e kryera gjatë edukimit profesional, pedagogjik dhe angazhimet tjera të ndryshme.

### 2.1 Verifikimi kualitativ i dijes

Që të arrihet specializim kualitativ, dija e fituar dhe aftësitë e specializantit verifikohen me mbikqyrje të përhershme dhe verifikim sipas lëmive me kolokviume. Mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë ose indirekte mbi dijen dhe aftësitë e fituara e bejnë mentorët. Kjo mbikqyrje është e përditshme. Vlerësimi i dijes së specializantit bëhet në formë të kolokviumeve pas përfundimit të të njëjsteve të veçanta mësimore. Kolokviumet mund të jenë të shkruara apo gojore. Dija verifikohet me prezentimin e rasteve të sëmundjeve, përgaditjes së seminareve, përcjelljes së literaturës, shkruarjes së punimeve dhe pjesëmarrjes në prezente. Specializanti duhet që së paku një herë në vit publikisht të prezentojë dijen e fituar në mënyrën që ia cakton mentorin e vet apo mentorin kryesor:

- Prezentimi i analizës së grupit të sëmuarëve apo rastit posaqërisht interesant klinik në tubime profesionale në institucionin arsimor ose institucion tjetër
- Përgaditja dhe udhëheqja e konferencës klinike ose kliniko-patologjike me temë që përfshihet nga lëmia e specializimit
- Publikimi i punimit në revistën e recenzuar të vendit apo ndërkombëtare me temë nga programi i specializimit.

Kusht për vazhdimin e specializimit janë kalimi i sukseshëm i kolokviumeve dhe nota kaluese vjetore e mentorit kryesor.

## 3. PROGRAMI I SPECIALIZIMIT

### 3.1. Vëllimi i programit

#### 3.1.1. Njohuritë teorike:

01. Anatomia funksionale e kokës dhe qafës
02. Biologjia e indeve mbështetëse të dhëmbit dhe fiziologjia orale
03. Mikrobiologjia orale dhe mikrobiologjia e depozitimeve orale
04. Tabloja klinike e sëmundjeve parodontale
05. Terapia e sëmundjeve parodontale- faza fillestare
06. Radiologjia orale
07. Farmakologjia e indeve mbështetëse të dhëmbit dhe mukozave orale
08. Patogjeneza e sëmundjeve parodontale
09. Epidemiologjia e sëmundjeve parodontale
10. Simtomet e sëmundjeve orale të sëmundjet sistematike- roli i përgjegjes imunologjike

11. Përgaditja e pacientëve me faktor të rrezikut për ndërhyrje kirurgjike parodontale
12. Terapia antimikrobiale e sëmundjeve parodontale
13. Trauma okluzale
14. Terapia e sëmundjeve parodontale- kirurgjia parodontale
15. Marrëdhëniet e sëmundjeve parodontale me disiplinat tjera stomatologjike
16. Faktorët akcesor që ndikojnë në zhvillimin e sëmundjeve parodontale
17. Zhvillimi dhe bazat e implantologjisë stomatologjike
18. Indikacionet, kundërindikacionet, përparësitë dhe dobësitë e sistemeve implantologjike
19. Efloreshencat e mukozave të kavitetit oral
20. Testet për diagnostifikimin e sëmundjeve të mukozave të kavitetit oral
21. Diagnoza dhe terapia e vatrave fokale orale dhe sëmundjeve konsekuative

Dija teorike realizohet në seminare, diskutime nga kapitujt e parashtruar dhe vlerësimet kritike të punimeve nga revistat kryesore profesionale.

### **3.1.2. Njohuritë praktike**

1. Diagnostika e sëmundjeve të mukozave orale dhe indeve mbështetëse dhe mënyrat e shërimit
2. Njohja paraklinike e instrumenteve dhe studimi i teknikave kirurgjike në modele
3. Terapia fillestare e sëmundjeve parodontale
4. Terapia akluzale dhe ortodontike
5. Terapia kirurgjike parodontale
6. Teknika kirurgjike e implanteve stomatologjike
7. Faza e mirëmbajtjes së shërimit

## **3.2. Ecuria e specializimit**

### **3.2.1. Programi fillestar**

Në programin fillestar, i cili zgjat 12 muaj (me një muaj pushim) kandidati duhet ti përvetësoj njohuritë teorike, të cekura në pikat 1 e deri në 10, dhe njohuritë praktike të cekura në pikat prej 1 e deri në 3, nga vëllimi I programit të specializimit nga parodontologjia dhe mjekësia orale (2.1.)

### **3.2.2. Programi i mëtutjeshëm**

Në programin e mëtejshëm, i cili zgjat 12 muaj ( me një muaj pushim) kandidati duhet ti përvetësoj njohuritë teorike të cekura në pikat 11 e deri në 21, dhe njohuritë praktike të cekura në pikat 4. e deri në 7 nga Vëllimi I specializimit nga parodontologjia dhe mjekësia orale(2.1.)

Në pjesën tjetër të specializimit specializanti në mënyrë të pavarur diagnostifikon dhe trajton sëmundjet parodontale dhe të indeve të buta orale dhe merr pjesë në ushtrimet e sëmundjeve orale dhe parodontologjisë për studentët e stomatologjisë.

### **3.1 Ndërhyrjet obligative klinike gjatë specializimit**

Specializanti i parodontologjisë dhe mjekësisë orale duhet të realizojë së paku këto ndërhyrje klinike nga këto lëmi :

- |           |   |            |
|-----------|---|------------|
| <b>1.</b> | Ekzaminimi, diagnoza dhe terapia e pacientëve të sëmur nga sëmundjet e indeve të buta orale ; | <b>30</b>  |
| <b>2.</b> | Anamneza, ekzaminimi dhe regjistrimi i gjendjes së pacientëve me sëmundje parodontale         | <b>30</b>  |
| <b>3.</b> | Ndërhyrjet kirurgjike parodontale   | <b>20</b>  |
| <b>4.</b> | Vendosja e implanteve dentale   | <b>3-5</b> |
| <b>5.</b> | Diagnoza dhe terapia e vatrave fokale orale   | <b>20</b>  |

Specializanti duhet që secilën fazë të shërimit të çdo pacienti ta dokumentoj detajisht me regjistrimin e gjendjes, modele dhe diapozitive.

### **4.1 Pranimi i aftësisë të mëhershëm si pjesë e programit të specializimit**

Nëse specializanti i ka mbaruar studimet postdiplomike në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, i pranohet si me krye 6 muaj specializim nga lëmia e parodontologjisë dhe mjekësisë orale.